



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
NDËRMARRJA E PASURISË PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

NR____prot

DATA: 03/08/2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Gazoili për nevojat e NPP dhe Bordit të Ujitjes dhe Kullimit”

Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Naftë
09134000-7 Benzinë 09132000-3

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 37,654,154.376(tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër pikë treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) LEKË PA TVSH.

Buxheti i shtetit + Vetëfinancim.

Vlera e fondit limit është përcaktuar bazuar në evidencat e shpërndarjes së karburantit në bazë të sasisë për vitin 2025(dhjetor) dhe vitin 2026 ,kronometrimit të normave të harxhimit të karburantit për mjetet e Ndërmarrjes, mjetet e Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, dhe mjeteve të Brigadës së Pastrimit si dhe në informacionin mbi cmimet e karburantit të nxjerrë nga Kryetarët e Degeve Doganore, Departamentit të Akcizës, Departamentit Operativ - Hetimor dhe Agjensisë së Prokurimit Publik:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, ka hartuar procesverbalin për

argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1 Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

1.2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

ARGUMENTIMI: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

EN-ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

EN-ISO 14001:2015 Kërkesa për certifikimin sipas ISO 14001 është vendosur për të garantuar që operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë zbatojnë standarde të njohura ndërkombëtarisht për menaxhimin e ndikimit në mjedis.

Procesi i prodhimit dhe furnizimit të betonit përfshin aktivitete që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, si përdorimi i inerteve, emetimet e pluhurit, zhurmat, si dhe menaxhimi i mbetjeve industriale. Në këtë kuadër, kërkohet që operatorët ekonomikë të disponojnë një sistem të strukturuar për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e këtyre ndikimeve.

Zbatimi i standardit ISO 14001 siguron që operatori ekonomik:

- vepron në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi;
- ndjek politika të qëndrueshme në përdorimin e burimeve natyrore;
- garanton monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore.

Vendosja e kësaj kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës dhe është proporcionale me objektin e prokurimit, pasi synon të sigurojë furnizim me mallrat objekt prokurimi nga operatorë që respektojnë standardet mjedisore dhe reduktojnë ndikimet negative në ambient.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin gjejmë të përcaktuar se: "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës., , si dhe pikat 1,2 pika c) ,3 të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor, të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023,2024,2025) të paraqitur në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara nga ky Autoritet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, "Gjithashtu Autoritetet ose Entet Kontraktore mund të kërkojnë që Operatorët ekonomik të japin informacione në Bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit" LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

3.Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

3.1.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose licencat përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, të naftës dhe nënprodukteve të saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.

Gjithashtu është vendosur në përputhje me ligjin Nr.8450, datë: 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzinës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, neni 10, 19, 20(i ndryshuar me Aktit Normativ Nr. 5, datë 12.3.2022) si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 40 pika 5“a”.

Ky kriter është vendosur për të garantuar furnizimin e pandërprerë, të sigurt dhe në kohë me gazoil për Autoritetin Kontraktor. Disponimi i të paktën një pike të licencuar tregtimi me pakicë vërteton se operatori ekonomik ushtron ligjërisht aktivitetin e tregtimit të karburanteve, disponon infrastrukturën e nevojshme për furnizim dhe është në gjendje të realizojë furnizimet sipas

kërkesave të kontratës. Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcionale me natyrën e kontratës dhe synon të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit, cilësinë e karburantit dhe respektimin e legjislacionit në fuqi.

3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Fletë analizë ose raport analize i cilësisë së diesel 10 ppm ULSD, lëshuar nga organet kompetente, jo më parë se 12 muaj nga data e hapjes së procedurës.

b.Vërtetimin teknik nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit,për respektimin e normave teknike të karburantit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligji nr. 162/2020 dhe pikës 6/c të nenit 40 të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë paraqitjen e dokumentacionit teknik që vërteton përputhshmërinë e mallrave me specifikimet e kërkuara.

Në këtë kuadër, kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë raport testimi dhe/ose raport analizash dhe/ose skedë teknike për mallin objekt prokurimi vendoset për të garantuar që produkti i ofruar përmbush të gjitha karakteristikat teknike dhe standardet e kërkuara në DST.

Ky kriter është kërkuar për të garantuar që karburanti që do të furnizohet përmbush standardet e cilësisë të përcaktuara në legjislacionin shqiptar dhe standardet përkatëse teknike. Fleta e analizës ose raporti i analizës i lëshuar nga organet kompetente provon përputhshmërinë e produktit me parametrat teknikë të kërkuar, duke siguruar mbrojtjen e automjeteve dhe pajisjeve të Autoritetit Kontraktor, si dhe funksionimin normal të tyre. Kërkesa që dokumenti të mos jetë më i vjetër se 12 muaj garanton që cilësia e produktit është e verifikuar në një periudhë të afërt me zhvillimin e procedurës.

b.Vërtetimin teknik nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit,për respektimin e normave teknike të karburantit.

Ky kriter është vendosur për të provuar se karburanti përmbush kërkesat teknike dhe standardet në fuqi, të verifikuara nga një organ i pavarur dhe i autorizuar. Ky dokument siguron besueshmëri mbi cilësinë e produktit që do të furnizohet, minimizon rrezikun e furnizimit me karburant jashtë standardeve dhe garanton mbrojtjen e interesit publik gjatë zbatimit të kontratës.

3.3.Operatori ekonomik duhet të sigurojë furnizim të pandërprerë, 24 orë,në 7 ditë të javës,në qytetin ku ndodhet Autoriteti Kontraktor, si dhe në të gjitha stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë me pistoletë publike, (ku ai ushtron veprimtarinë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit dhe nevojat e Autoritetit Kontraktor për furnizim të vazhdueshëm me karburant. Automjetet dhe mjetet e institucionit mund të jenë në shërbim në çdo kohë, përfshirë ditët e pushimit dhe rastet emergjente. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të garantojë furnizim pa ndërprerje në stacionet e tij të shitjes me pakicë, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve publike dhe shmangien e ndërprerjeve në aktivitetin e Autoritetit Kontraktor. Kriteri është proporcional dhe i domosdoshëm për realizimin normal të kontratës.

3.4.Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera,(Ekstrakti tregtar i QKR-së i shoqëruar me dokument pronësie ose kontratë qeraje), së paku një pikë furnizimi brenda territorit të qytetit të Lushnjes, e vlefshme për të gjithë afatin e zbatimit të kontratës për këtë objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kriteri 3.4 është vendosur në përputhje me Ligjin Nr.8450, date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzinës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”(i ndryshuar me Aktin Normativ Nr. 5, datë 12.3.2022).

Ky kriter është vendosur për të garantuar akses të shpejtë dhe efikas të automjeteve të Autoritetit Kontraktor në furnizimin me karburant. Disponimi i një pike furnizimi brenda territorit të qytetit të Lushnjës mundëson uljen e kohës së lëvizjes dhe kostove operative, shmang konsumimin e panevojshëm të karburantit dhe siguron reagim të menjëhershëm gjatë kryerjes së shërbimeve publike dhe situatave emergjente. Kërkesa është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, është proporcionale dhe synon të garantojë ekzekutimin e rregullt dhe efektiv të saj gjatë gjithë afatit të zbatimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë

*cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT